



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

Nr. 77 prot.

Tiranë, më 13.01.2026

VENDIM

Nr.03, datë 13.01.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit nr. 8/2023 «Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror», Urdhrit nr. 644, datë 31.10.2025 të Ministrit të Drejtësisë « Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit », Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 « Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë », të ndryshuar, Urdhrit nr. 53 Prot., nr. 06, datë 12.01.2026 « Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror »,

V E N D O S A :

1. Miratimin e Planit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2026, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORIA PËRGJITHSHËM

Erçys QIRICI



Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Atatürk", Tiranë

Tel 22328900, web: www.dpp.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

Lidhja nr. 1 – Plani Vjetor i Inspektimeve për vitin 2026

Nr.	Lloji i inspektimit	Titulli i inspektimit	Periudha e realizimit të inspektimit	Zyra Përmbare e inspektuar
1	Intitucional	Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbare	02.03.2026 – 30.06.2026	Zyra Përmbare Krujë
2	Institucional	Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbare	02.03.2026 – 30.06.2026	Zyra Përmbare Përmet
3	Institucional	Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbare	02.03.2026 – 30.06.2026	Zyra Përmbare Tropojë
4	Institucional	Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbare	02.03.2026 – 30.06.2026	Zyra Përmbare Mat
5	Institucional	Veprimtaria procedurale dhe administrative e zyrës përmbare	02.03.2026 – 30.06.2026	Zyra Përmbare Pukë
6	Tematik	Procedura e shitjes në ankand të sendeve të paluajtshme gjatë ekzekutimit të çështjeve përmbare me objekt “kthim shume”	01.07.2026 – 15.12.2026	Lezhë, Lushnjë, Kukës, Korçë, Tiranë
7	Tematik	Pushimi i çështjeve përmbare, ku debitori është subjekt që përfiton nga ligji për amnistinë, dhe ligji për faljen e gjobave administrative, konform nenit 616 të KPC.	01.07.2026 – 30.11.2026	Vlorë, Berat, Elbasan
8	Tematik	Pezullimi i çështjeve përmbare, konform nenit, 615/dh të KPC.	01.07.2026 – 30.11.2026	Gjirokastrë, Sarandë, Fier, Durrës
9	Tematik	Veprimet përmbare pas marrjes formë të prerë të vendimit të pushimit të ekzekutimit	01.07.2026 – 30.11.2026	Kavajë, Dibër, Kurbin, Pogradec